



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2023:222456

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05313568

C.nr.906/23

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit R.B nga Vushtri të cilin e përfaqëson av.T.I nga Prishtina kundër të paditurës K.S. “Y...” me seli në Prishtinë, lidhur me kompensim dëmi, jashtë seance, me datën 12.02.2024 e mori këtë:

A K T G J Y K I M
në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I.REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit R.B nga Vushtri kundër të paditurës K.S. “Y...” me seli në Prishtinë, lidhur me kompensim dëmi.

II.Secila palë i batë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë, me datën 19.10.2023, ka paraqitë në Gjykatë padi kundër të paditurës K.S. “Y...” me seli në prishtinë, lidhur me kompensim dëmi.

Me datën 09.02.2024, paditësi me anë të autorizuarit të tij ka parashtruar një parashtrësë ku ka deklaruar se heqim dorë nga kërkesëpadia, në këtë çështje juridiko-civile, meqenëse me të paditurën kemi lidhur marrëveshje.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 149 par. 1 të LPK-së në të cilën parashihet se: “Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë” dhe 149 paragrafi 2 në të cilin thuhet:”Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur”, si dhe meqenëse u konstatua se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të këtij ligji), e në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 143 par 1 e 452 të Ligjit nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRI

- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.906/23, datë: 12.02.2024

Gj y q t a r i:
Izet Gërguri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e prnimit, Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.